

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga ELKEM ASA me seli në Dramensvajen 169, Oslo, Norvegji, nëpërmjet personit të autorizuar Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 08.02.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga ELKEM ASA me seli në Dramensvajen 169, Oslo, Norvegji nëpërmjet ndërmarrjes-bijë të saj në pronësi të plotë të Elkem Karbon AS, me seli të regjistruar në Dramensvajen 169, Oslo, Norvegji mbi shoqërinë VUM a.d., me seli të regjistruar në Priemiselna 12, 965 63 Zhiar mbi Hronom, Republika Sllovake, nëpërmjet blerjes dhe shitjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 09.01.2023, e plotësuar më 23.01.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga ELKEM ASA me seli në Dramensvajen 169, Oslo, Norvegji, me të cilin ELKEM ASA nëpërmjet ndërmarrjes-bijë të saj në pronësi të plotë të Elkem Karbon AS, me seli të regjistruar në Dramensvajen 169, Oslo, Norvegji do të fitoj kontroll të vetëm mbi shoqërinë VUM a.d., me seli të regjistruar në Priemiselna 12, 965 63 Zhiar mbi Hronom, Republika Sllovake, nëpërmjet blerjes dhe shitjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Elkem ASA është një prodhues i silikonit, legurave për industrinë e shkrites, karbonit dhe mikrosilikës dhe një furnizues global i zgjidhjeve të materialeve të avancuara, me seli në Oslo, Norvegji.

Elkem Karbon AS është një shoqëri brenda divizionit të Karbon Solushns” të Elkem, e cila furnizon produkte dhe shërbime me bazë karboni për industritë e fero-legurave, silikonit dhe aluminit.

Elkem ASA nuk ka subjekte juridike të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Elkem Karbon gjeneroi të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga shitja e pastës së elektrodave.

VUM A.S. është një shoqëri aktive në tregun e produkteve të karbonit e themeluar në Sllovaki me rreth 100 punonjës.

VUM A.S. nuk ka persona juridikë të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски